

Florida.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2905 Prot.

Lezhë, më 04 . 03 . 2024

VENDIM

Nr. 11, Datë 29. 02. 2024

Për një shtesë në VKB nr.70, datë 14.12.2023 “Për miratimin e PBA-së 2024-2026 dhe Buxhetit të vitit 2024” dhe përdorimin e fondeve të trashëguara të tërmetit nga viti 2023

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI :

1. Miratimin e një shtese në VKB nr.70, datë 14.12.2023 “Për miratimin e PBA-së 2024-2026 dhe Buxhetit të vitit 2024”, dhe përdorimin e fondeve të trashëguara të tërmetit nga viti 2023, si më poshtë:

1/1-Të shtohen burimet në buxhetin e vitit 2024 në shumën 203,768,990 lekë, fonde të akorduara për tërmetin, të trashëguara nga viti 2023.

1/2-Të shtohen shpenzimet në shumën 203,768,990 lekë, sipas projekteve si më poshtë:

- Gr.00, Prog.04520, Kap.01, Art.231 për shumën 292,898 lekë, e konkretisht për: Punime ndërtimi për objektin “Rindërtim i Urës së Zezë mbi lumin Drin” në shumën 248,395 lekë dhe mbikëqyrje punimesh në shumën 44,503 lekë. Kodi i Projektit 94902AE.
- Gr.00, Prog.04690, Kap.06, Art.606 për shumën 2,200,000 lekë, e konkretisht për: Rikonstruksion banesa individuale në shumën 2,200,000 lekë. Kodi i Projektit 94902AB.
- Gr.00, Prog.06140, Kap.01, Art.602 për shumën 15,835,267 lekë, e konkretisht për: Shembjen e objekteve të dëmtuara nga tërmeti në shumën 14,243,300 lekë, mbikëqyrje punimesh në shumën 1,508,894 lekë dhe kolaudim punimesh në shumën 83,073 lekë. Kod Projekti 94902AH.
- Gr.00, Prog.06140, Kap.01, Art.230 për shumën 2,175,025 lekë, e konkretisht për: Hartim projektsh të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse në shumën 2,175,025 lekë. Kod Projekti 94902AI.

- Gr.00, Prog.06140, Kap.01, Art.231 për shumën 17,835,093 lekë, e konkretisht për: Financim i rindërtimit të banesave individuale dhe njërive të banimit në shumën 17,835,093 lekë, Kod Projekti 94902 AC.
- Gr.00, Prog.06140, Kap.01, Art.231 për shumën 16,794,988 lekë, e konkretisht për: Rikonstruksion i mjediseve në bashkëpronësi dhe njërive të banimit në shumën 1,220,403 lekë, Riforcim i njërive të banimit në shumën 14,963,035 lekë dhe kolaudim punimesh në shumën 611,550 lekë. Kod Projekti 94902AB.
- Gr.00, Prog.06140, Kap.06, Art.231 për shumën 3,552,285 lekë, e konkretisht për: Rikonstruksion i mjediseve në bashkëpronësi dhe njërive të banimit në shumën 3,201,861 lekë, mbikëqyrje punimesh në shumën 263,259 lekë dhe kolaudim punimesh në shumën 87,165 lekë. Kod Projekti 94902AB.
- Gr.00, Prog.06140, Kap.01, Art.606 për shumën 131,969,348 lekë, e konkretisht për: Grante për rindërtimin në shumën 71,131,869 lekë, Financimi i rindërtimit të banesave individuale në shumën 60,837,479 lekë. Kod Projekti 94902AB.
- Gr.00, Prog.08820, Kap.01, Art.231 për shumën 7,140,572 lekë, e konkretisht për : Rikonstruksionin e Bibliotekës Lezhë në shumën 3,525,029 lekë, Rikonstruksionin e Pallatit të Kulturës Lezhë në shumën 3,595,853 lekë, Kolaudim punimesh në shumën 19,690 lekë. Kod Projekti 94902AE.
- Gr.00, Prog.08820, Kap.06, Art.231 për shumën 258,943 lekë, e konkretisht për : Rikonstruksionin e Pallatit të Kulturës Lezhë në shumën 258,943 lekë. Kod Projekti 94902AE.
- Gr.00, Prog.09120, Kap.01, Art.231 për shumën 3,724,427 lekë, e konkretisht për : Ndërtimin e Shkollës 9 vjeçare Shëngjin në shumën 147,426 lekë, Mbikëqyrje punimesh në shumën 2,800,001 lekë dhe Kolaudim punimesh në shumën 777,000 lekë. Kod Projekti 94902AD.
- Gr.00, Prog.09240, Kap.01, Art.231 për shumën 1,839,749 lekë, e konkretisht për : Ndërtimin e Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale në shumën 1,839,749 lekë. Kod Projekti 94902AD.
- Gr.00, Prog.09240, Kap.06, Art.231 për shumën 150,395 lekë, e konkretisht për : Ndërtimin e Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale në shumën 150,395 lekë. Kod Projekti 94902AD.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
NDUE LULI





KB.
Nr 2903/Prot
07.11.03-24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 116/ Prot.
6

Lezhë, më 02.03.2024

Lënda: **Konfirmim vendimi**

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.68, datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes vendore", ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë të ndryshuar"; si dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.11, datë 29.02.2024 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për një shtesë në VKB nr. 70, datë 14.12.2023 "Për miratimin e PBA-së 2024-2026 dhe buxhetit të vitit 2024 dhe përdorimin e fondeve të trashëguara të tërmetit nga viti 2023".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

